



Ky projekt u financua nga Bashkimi Evropian



HAZARDOUSWM.EU

PROGRAMI I REHABILITIMIT TË LABORATORIT TË SHKOLLAVE TË TIRANËS




This publication material was produced with the financial support of the European Union. Its contents are the sole responsibility of Barleti University and do not necessarily reflect the views of the European Union.

Botimi i këtij materiali është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Universitetit Barleti dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

01

Shkollat e mesme në të gjithë vendin përdorin substanca të rrezikshme në baza ditore. Laboratorët e kimisë dhe biologjisë i mirëmbajnë këto kimikate për të edukuar studentët rreth koncepteve të rëndësishme shkencore; programet profesionale i përdorin ato për të trajnuar studentët në profesione të rëndësishme si saldimi dhe mekanika e automobilave. Ndërsa këto substanca janë një pjesë e domosdoshme e edukimit dhe trajnimit, ato shkaktojnë probleme kur vjen koha për t'i asgjësuar.



02



Mbetje e rrezikshme është çdo material që përmban kimikate të rrezikshme ose shfaq një karakteristikë të mbetjeve të rrezikshme (ndezueshmëri, gërryerje, toksicitet, reaktivitet).

Shembuj të mbetjeve të rrezikshme përfshijnë merkurin, acidet, bazat, oksiduesit, bojërat, tretësit, bateritë, pesticidet, herbicidet, aerosolet dhe lëngjet e automobilave.

Këto mbetje mund të përbëjnë një kërcënim serioz për shëndetin e përdoruesit, si dhe për mjedisin, kur hidhen në mënyrë jo të duhur. Hedhja e duhur e këtyre materialeve mund të kushtojë deri në dhjetëfishin e çmimit fillestar të blerjes.

03

Programi Tirana Schools Lab Rehab (TSLRP) është ndertuar për t'u ofruar shkollave një mundësi për të mësuar rreth praktikave të sigurisë kimike dhe për të ofruar informacion për një asgjësim të sigurt të mbetjeve të rrezikshme nga ambientet e shkollave publike.

Shkollat publike mund të planifikojnë një ngjarje edukative në internet për të mësuar më shumë rreth kimikateve të vendosura në klasat dhe zonat e tyre të ruajtjes, si dhe rëndësinë e mbajtjes së një mjedisi të sigurt në klasë duke përdorur kiminë e gjelbër. Gjatë ngjarjes edukative në internet, Koordinator i TSLRP do të diskutojë se si të menaxhojë siç duhet materialet në shkollë, të ndihmojë shkollën të marrë vendimin se cilat materiale duhet të asgjësohen në mënyrë të sigurt dhe të sugjerojë këshilla të ardhshme për blerjen e kimikateve për të ruajtur një mjedis të sigurt për stafin dhe nxënësit. Trajtimi do të largojë çdo kimikat të padëshiruar, të skaduar, të komprometuar ose të paqëndrueshëm nga shkolla në mënyrë të sigurt dhe me përgjegjësi nga ekspertë të trajnuar. Kjo është një mundësi e shkëlqyer për të reduktuar toksicitetin e përgjithshëm në klasa dhe shkolla.